



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-159
Prishtinë, 27 mars 2014

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 27 E 28 MARS DHE 3 PRILL 2014**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së parë plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Burim Ramadani, Gëzim Kelmendi, Myfera Shinik, Glauk Konjufca, Xhevahire Izmaqi, Vjollca Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Rada Trajković, Daut Haradinaj, Jakup Krasniqi dhe zv./kryeministrja Edita Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Kymete Bytyçi parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me trajtimin e kërkesës për përkujdesje institucionale të familjarëve të Enver Malokut, Xhemal Mustafës, Shaban Manajt, Ukë Bytyçit, Ismet Rracit, Smajl Hajdarit, të vrarë gjatë dhe pas luftës në Kosovë.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Shaip Muja parashtrroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se a janë shteruar procedurat paraprake lidhur me prangosjen e mjekut dr. Shpend Elezi.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Shaip Muja.

Deputetja Albana Gashi parashtrroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me ndërprerjen e masës së suspendimit për zv/komandantin e Stacionit të Policisë në Zubin Potok, Jugosllav Bugovac, i cili ka qenë përgjegjës për sigurimin e të arrestuarit Slobodan Sovrlji, në Stacionit e Policisë në Zubin Potok.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Albana Gashi.

Deputetja Time Kadrijaj parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me kohën se kur do të fillojë aplikimi për trajtim shëndetësor të fëmijëve me leukemi dhe sëmundje tjera, në fondin e krijuar nga refuzimi i rritjes së pagave për anëtarët e Kabinetit Qeveritar, për Presidencën dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë, mirëpo me pëlqimin e deputetes Time Kadrijaj, në pyetjen e saj u përgjigj ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani.

Deputetja Time Kadrijaj parashtrroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me mundësinë që personat e zhdukur të identifikuar të kategorizohen në kategorinë e viktimave civile të luftës.

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Lumnije Morina parashtrroi pyetje për ministri Bernard Nikaj në lidhje me mos vazhdimin e autorizimit për laboratorin SIERRA LAB SHPK, për testimin e derivateve të naftës edhe pse i njëjti, siç tha ajo i ka plotësuar të gjitha kushtet sipas Udhëzimit Administrativ 07/2012 të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Ministri Bernard Nikaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Salihe Mustafa parashtrroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me shkaqet që disa nga personat e shurdhër nuk i kanë marrë pensionet e tyre kohëve të fundit.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Deputetja Vjollca Krasniqi parashtrroi pyetje për ministri Memli Krasniqi në lidhje me realizimin e ndërtimit të ndonjëres nga gjashtë fushat ndihmëse të futbollit në Kosovë.

Ministri Memli Krasniqi iu përgjigj pyetjes së deputetes Vjollca Krasniqi.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtrroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me vlerën e investimeve në Klinikën e Kardiokirurgjisë në QKUK dhe numrin e pacientëve të trajtuar.

Ministri Ferid Agani u përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtrroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me numrin e rasteve emergjente të trajtuara jashtë institucioneve shëndetësore publike, sipas Udhëzimit Administrativ për këtë çështje.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputeti Glauk Konjufca parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje atë se sa herë është ngritur çështja e shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, në takimet që ai ka pasur me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albana Gashi parashtroi pyetje për ministri Nenad Rashiq në lidhje me arsyet që një numër kaq i madh i personave të shurdhër janë larguar nga skema pensionale.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Albana Gashi.

Deputeti Faton Topalli parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se a është duke e vënë në dispozicion Ministria e Shëndetësisë hormonin e rritjes për fëmijët që kanë nevojë.

Ministri Ferid Agani u përgjigj pyetjes së deputetit Faton Topalli.

* * *

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës, për fjalë u paraqit deputetja, Flora Brovina.

Flora Brovina, në emër të GP të PDK-së propozoi që Kuvendi të votojë për shmangie nga Rregullorja e Punës për radhitje në rendin e ditës së punimeve të mbledhjes së sotme të pikës - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryetari, në lidhje me propozimin e deputetes Flora Brovina, kërkoi deklaratimet e grupeve parlamentare.

Për propozimin lartpërmendur u deklaruan deputetët: Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejane Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Arben Gashi - në emër të Komisionit për Legjislacion, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari, kërkoi nga deputetët e Kuvendit që në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit të deklarohen me votim për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, për procedimin në lexim të dytë të Projektligjit për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 110 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 31,
Abstenime -----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, për radhitjen në rend të ditës së pikës - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

* * *

Në vazhdim kryetari njoftoi Kuvendin se për pikën e propozuar - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, kërkohet gjithashtu shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, për të cilën duhet të deklarohen deputetët.

Kryetari, në lidhje me propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, për radhitjen apo jo të kësaj pike në rendin e ditës, kërkoi deklaratimet e grupeve parlamentare.

Për propozimin lartpërmendur u deklaruan deputetët: Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari, kërkoi nga deputetët e Kuvendit që në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit të deklarohen me votim për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, për procedimin në lexim të parë të Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 73,
Kundër ----- 21,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, për radhitjen në rend të ditës së pikës - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Ai konstatoi se kjo pikë radhitet si pikë e fundit në rendin e ditës.

* * *

Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti propozoi që pika - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, të radhitet në rendin e ditës si pikë me numër rendor gjashtë.

Kuvendi miratoi propozimin e nënkryetarit të Kuvendit, Sabri Hamiti.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Zgjedhja e Avokatit të Popullit,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013,
9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripanim,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

* * *

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Para deklarimit të deputetëve për miratim të procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 13, 14, 19 mars 2014, kryetari kërkoi të bëjë një përmirësim të konstatimit lidhur me pikën 13, zgjedhja e Avokatit të Popullit.

“Konkursi për Avokatin e Popullit duhet të përsëritet sipas procedurave të parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit”, përmirësohet me konstatimin: “vazhdon procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, sipas procedurave të parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit”.

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 13, 14, 19 dhe 20 mars 2014, u miratua me ndryshimin e paraqitur nga kryetari.

4. Zgjedhja e Avokatit të Popullit

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, mbajtur më 24 mars 2014, pas analizimit të nenit 9.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe të nenit 8.1 dhe nenit 9 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit, ka vlerësuar se ka paqartësi lidhur me procedurat e votimit dhe papajtueshmëri në mes nenit 9.2 të ligjit dhe nenit 8.1 të Rregullores.

Andaj bazuar në nenin 9.2 të ligjit, me të cilën kërkohet që të bëhet zgjedhja e Avokatit të Popullit, kërkoj nga deputetët të deklarohen për procedimin e mëtejshëm, para se të procedohet me votim.

Sipas nenit 9.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ne jemi brenda afatit, që nënkupton se e kemi arritur afatin ligjor.

Lidhur me këtë kemi dy (2) variante:

1. Të votohet për kandidatin e mbetur dhe nëse nuk e merr shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, Kuvendi e mbyll procesin e votimit dhe të marrë vendim për rishpallje të konkursit për pozitën e Avokatit të Popullit.

Ose

2. Të përsëritet votimi me tre (3) kandidatë dhe nëse asnjeri kandidat, pas tre (3) rrethesh të votimit, nuk e merr shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, Kuvendi e mbyll procesin e votimit dhe merr vendim për rishpallje të konkursit për pozitën e Avokatit të Popullit.

Në lidhje me procedimin sipas varianteve të lartëpërmenduar, kryetari kërkoi deklarimin e grupeve parlamentare.

Për procedimin sipas varianteve të lartë përmenduar u deklaruan deputetët: Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Suzan Novoberdaliu - në emër të Grupit Parlamentar të

Koalicioni Kosova e Re dhe në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Kuvendi do të procedojë sipas variantit të dytë të lartpërmendur, për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK – Blerta Deliu-Kodra,
2. GP LDK – Rita Hajzeraj,
3. GP “Vetëvendosje” - Albana Gashi,
4. GP AAK - Kymete Bajraktari,
5. GP - Koalicioni Kosova e Re – Jeton Svirca,
6. GP- “6+” – Duda Balje.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Rundi i parë i votimit:

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Blerta Deliu-Kodra.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 84 deputetë, ndërsa i pavlefshëm është 1 fletëvotim.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Adrijana Hoxhiq i ka fituar 5 vota,
2. Hilmi Jashari i ka fituar 41 vota,
3. Gjyljeta Mushkolaj i ka fituar 37 vota.

Ajo konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, në rundin e dytë do të hyjnë në votim kandidatët Hilmi Jashari dhe Gjyljeta Mushkolaj.

Rundi i dytë i votimit:

Pas numërimit të fletëvotimeve në rundin e dytë, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti, Blerta Deliu-Kodra.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 86 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 2 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Hilmi Jashari i ka fituar 43 vota,
2. Gjyljeta Mushkolaj i ka fituar 41 vota.

Më pas, kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Asnjëri nga kandidatët e propozuar, Adrijana Hoxhiq, Hilmi Jashari dhe Gjyljeta Mushkolaj, nuk i morën votat e nevojshme për t'u zgjedhur Avokat të Popullit.

2. Konkursi për Avokat të Popullit duhet të përsëritet sipas procedurave të parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Zv/kryeministria Edita Tahiri tha se ky projektligj përcakton organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Më pas, theksoi se ky projektligj ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale si dhe krahaskimin dhe zgjidhjen e dallimeve ndërmjet dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga ish- regjimi serb para qershorit të vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.

Në vazhdim, ajo foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e znj. Edita Tahiri është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi - në emër të Komisionit për Legjislacion dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje"; Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Xhafer Tahiri dhe zv/kryeministria Edita Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 44,
Kundër -----14,
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Kryesuesi pastaj hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, dhe 3.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin nr. 04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ajo në fund e përkrahu raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013. Fjala e znj. Safete Hadërgjonaj është dhënë e plotë në transkript.

Kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Hykmete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Albana Fetoshi, Safete Hadërgjonaj, Hykmete Bajrami dhe Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim.

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013

Deputetja Safete Hadergjonaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ajo në fund e përkrahu raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013.

Fjala e znj. Safete Hadergjonaj është dhënë e plotë në transkript.

Kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Hykmete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albana Fetoshi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Muhamet Mustafa dhe Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryetari konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim.

* * *

Në vazhdim kryetari konstatoi se Kuvendi i përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa vazhdimi i punimeve të kësaj mbledhje plenare do të bëhet më 28 mars 2014, në orën 10:00.

* * *

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:30 minuta.

* * *

28 mars 2014, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 27 mars 2014

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Nënkryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 27 mars 2014.

Ai procedoi me pikat, si në vijim:

7. Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013

Nënkryetari, i Kuvendit konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim.

8. Votimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013

Nënkryetari konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim.

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim

Kryesuesi i njoftoi deputetët për Raportin me rekomandimet të Komisionit për Integritet Evropian për Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim

Deputetja Blerta Deliu-Kodra, në emër të Komisionit Funkcional për Integritet Evropian paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim.

Diskutimi i deputetes Blerta Deliu-Kodra është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Blerta Deliu-Kodra - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Alma Lama- në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Glauk Konjufca - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; ndërsa Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Halit Krasniqi, Skender Hyseni dhe Xhafer Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile

Kryesuesi i njoftoi deputetët se deputeti Glauk Konjufca dhe grupi i deputetëve nënshkruar, ka kërkuar miratimin e Projekt-deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile.

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2014, ka propozuar që kjo pikë të radhitet në seancën e sotme plenare.

Ai më pas ftoi deputetin Glauk Konjufca, në emër të grupit të deputetëve nënshkruar, në cilësinë e propozuesit të çështjes, të paraqesë dhe ta arsyetojë para Kuvendit, Projekt-deklaratën për partneritet ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile.

Glauk Konjufca tha se në mënyrë që të avancohet bashkëpunimi me shoqërinë civile, Kuvendit të Kosovës i nevojitet një dokument i cili do të përmbante parimet e angazhimit të shoqërisë civile. Në projekt-deklaratën e ofruar, Kuvendi zotohet që në mënyrë aktive të bashkëpunojë me shoqërinë civile, të përkrahë zhvillimin e këtij sektori në tërësi dhe t’u ofrojë qasje transparente në punën e komisioneve të veta.

Në vazhdim deputeti Konjufca theksoi se bashkëpunimi i Kuvendit me shoqërinë civile është rekomanduar gjithashtu në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën të vitit 2013 si dhe nga Projekti i binjakëzimit.

Projekt-deklarata e ofruar gëzon mbështetje nga sektori i shoqërisë civile në Kosovë dhe si i tillë është arritur pas konsultimit me më tepër se 70 organizata të tilla në vend.

Diskutimi i deputetit Glauk Konjufca është dhënë i plotë ne transkript.

Kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Halit Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; ndërsa Myzejane Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Xhevdet Neziraj, Sabri Hamiti dhe Blerta Deliu-Kodra, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Para se të fillonte me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, kryesuesi Xhavit Haliti, propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës me arsyetimin se në sallë është një numër fare i vogël i deputetëve, gjithsej 34.

* * *

Në vazhdim kryesuesi, konstatoi se Kuvendi i përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa për vazhdimin e punimeve të kësaj mbledhje plenare do të vendosë Kryesia e Kuvendit në takimin e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 11:20 minuta.

* * *

3 prill 2014, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 27 mars 2014 dhe e vazhduar më 28 mars 2014

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 27 e 28 mars 2014.

Ai procedoi me pikat, si në vijim:

7. Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013

Kryetari theksoi se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyer për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 35,
Kundër -----35,

Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk e miratoi raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2013.

8. Votimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013

Kryetari theksoi se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyer për mbledhjen e sotme.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 51,
Kundër -----24,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013.

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim

Kryetari theksoi se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyer për mbledhjen e sotme.

Kryetari e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 79,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L--208 për ripranim.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile

Kryetari theksoi se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyrë për mbledhjen e sotme.

Kryetari e hodhi në votim Projekt-deklaratën për partneritet ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----79,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi këtë:

D E K L A R A T Ë

1. Kuvendi angazhohet të rrisë pjesëmarrjen e publikut në hartimin, shqyrtimin dhe zbatimin e legjislacionit në Kuvendin e Kosovës,
2. Kuvendi zotohet të avancojë bashkëpunimin ndërmjet institucionit tonë dhe Shoqërisë Civile nëpërmjet bashkëpunimit të rregullt, rritjes së shkëmbimit të informatave dhe zhvillimit të aktiviteteve në projekte të përbashkëta,
3. Kuvendi e mbështet vullnetarizmin dhe aktivizimin qytetar për promovimin dhe zhvillimin e demokracisë në Kosovë,
4. Kuvendi angazhohet ta zhvillojë një kornizë të favorshme ligjore dhe financiare, e nevojshme për zhvillimin dhe forcimin e Shoqërisë Civile në Kosovë.
5. T'i zhvillojë dhe zbatojë procedurat e nevojshme që garantojnë konsultim me publikun, përfshirë Shoqërinë Civile në punët e Kuvendit,
6. Inicimin dhe shqyrtimin e legjislacionit, si dhe proceset e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij legjislacioni,
7. Të krijojë projekte dhe aktivitete të përbashkëta me Shoqërinë Civile për të promovuar pjesëmarrjen e publikut në punën e Kuvendit të Kosovës, pra në formë të fushatave, të vetëdijesimit dhe të përfshirjes,
8. Të bashkëpunojë ngushtë me Shoqërinë Civile për zgjidhjen e çështjeve lidhur me rregullimin e financimit të aktivitetit të Shoqërisë Civile për ta mbështetur zhvillimin e një sektori të fuqishëm dhe të pavarur të Shoqërisë Civile në Kosovë.
9. Të organizojë të paktën një herë në vit një konferencë së bashku me Shoqërinë Civile, me qëllim të diskutimit të çështjeve strategjike të rëndësishme për zhvillimin e vendit, si dhe për të adresuar çështje të rëndësishme, të cilat lidhen me funksionimin e sektorit të Shoqërisë Civile, si dhe
10. Të themelohet një grup Kuvend - Shoqëri Civile, i përbërë nga deputetë dhe stafi i Kuvendit, si dhe përfaqësues të ndryshëm të Shoqërisë Civile për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kësaj deklarate.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kryetari tha se Komisioni për Legjislacion, duke vepruar në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 04-V-764, të datës 31 janar 2014, ka hartuar Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në parim.

Në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, për këtë pikë të rendit të ditës nuk foli askush.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arsim Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Arben Gashi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myfera Shinik - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Enis Kervan, Halit Krasniqi, Alma Lama, Faton Topalli, Nijazi Idrizi, Jeton Svirca, Hydajet Hyseni, Haki Demolli, Visar Ymeri, Xhevdet Neziraj, Emilija Rexhepi, Amir Ahmeti, Gëzim Kelmendi, Bekim Haxhiu, Hamza Balje, Xhevahire Izmaqu, Rasim Demiri dhe Blerta Deliu-Kodra, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 64 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 44,
Kundër ----- 2,
Abstenime -----18.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

* * *

Kryesuesi i përfundoi punimet për ditën e sotme dhe mbylli punimet në orën 13:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale